- Pemet ne tava duhet te kene vetem majen te ekspozuar.
- Pemet nuk duhet te hiqen nga tava derisa te jene gati per t'u vendosur ne gropen e pergatitur.
- Fidanet duhet te largohen me kujdes, nje nga nje, per te parandaluar demtimin, e te vendosen shpejt ne gropen e mbjelljes.
- Fidanet e vendosura ne tava plastike nuk duhet te tejkalojne sasine e rekomanduuar per transport, ne menyre qe te shmanget demtimi I tyre, apo nxejja dhe tharja. Pemet e vendosura ne tava duhet te mbillen jashte dhe jo te magazinohen.
- Pemet e pergatitura duhet te mbillen brenda 24 oresh, me perjashtim te rasteve ekstreme te motit apo te kushteve te pappershtatshme te mbjelljes.

6. 4. Pergatitja e pemeve nga kontraktori

- Mbeshtillen mire pemet dhe vendosen shtrire me rrenjet jo te perdredhura, deri ne 50 peme ne 1 tufe.
- Mbeshtjellja duhet te behet ne zonat me hije te mbrojtura nga era. Rrenjet duhet te mbahen te njoma gjate gjithë kohes.

6.5. Distanca dhe perzgjedhja e vendeve te mbjelljes

- Kriteret per distancat midis pemeve
- Pemet duhet te mbillen ne vende te shperndara ne te gjithë siperfaqen e mbjelljes me nje distance prej 2m x 2m. Asnje peme nuk duhet te mbillet me afer se distanca mesatare e specifikuar nga pemet e mbjella apo nga ato ekzistuese.
- pikat e mbjelljes se pemeve duhet te vendosen ne vende te mbrojtura ku drute e prera, hunjte, trunget dhe tiparet e terrenit ofrojne mbrojtje prej diellit, eres, kafsheve, mbetjeve dhe agjenteve te tjere te demshem per rritjen e pemeve.

6. 6. Pergatitja e vendit te mbjelljes

Perpara mbjelljes se gropes, kontraktori duhet te pastroje vendin e mbjelljes nga drute, shkopat, mbetjet, hiri, gjethet e thara, bora, akulli, levoret, drute e kalbur, guret, rrenjet e kurorat e bimeve te gjalla dhe nga materiale te tjera, me qellim qe rrenjet te ekspozohen direkt ne toke te bute me minerale dhe te mundesohet nje mbirje dhe rritje e pershtatshme e fidaneve.

6. 6. Pergatitja e gropes se mbjelljes

Gropa e mbjelljes do te vendoset ne qender se zones se pergatitur. Gropa e mbjelljes duhet te jete e thelle dhe ne gjendje te akomodoje rrenjet e pemes qe do te mbillet. Gropa e mbjelljes duhet te kete permasat 40 x 40 x 40 cm (permasa ne gjatesi, gjeresi dhe thellesi).

6. 7. Vendosja e pemes

- Rrenjet e zhveshura duhet te vendosen ne qender te gropes me rrenje te vendosura ne menyre te natyrshme ne thellesi te tille qe pas mbushjes, paketimin dhe nivelimit, toka arrin ne nivel me vijen tokesore te pemes. Asnje pjese e rrenjes nuk duhet te ekspozohet dhe nuk duhet te mbulohen halat apo degjet e pemes me toke. Rrenjet nuk duhet te palosen, perdridhen apo grupohen. Sistemi i rrenjes duhet te jete ne nivel me aksin e gropes se mbjelljes me te gjitha rrenjet te drejtuara nga poshte.

- Pemet ne konteniere duhet te mbillen ne qender te gropes se pergatitur, ne thellesi 2-3 nen toke ne menyre qe te jene ne nivel me token rrethuese.


6. 8. Mbushja dhe ngjeshja

Rrenjet e pemeve do te mbushen me toke te bute minerale. Duhet te mos futen ne grope toka e thate, hiri, lenda organike, guret dhe materiale te tjera te huaja. Toka duhet te mbushet dhe te ngjeshet progresivisht ne menyre qe te mos mbetet toke e shkrifet apo xhepa ajri dhe pema te jete e qendrueshme. Kontraktori duhet te kujdeset qe pema dhe sistemi i rrenjes te mos demtohen. Pas mbjelljes, kercelli duhet te jete i drejte dhe i lire per t'u rritur.

6.9. Skema e pyllzimit




Skica e mbjelljes
Skema e pyllzimit



Formula e pyllzimit eshte 10 pishe mesdhetare.

Skema e pyllzimit qe do te zbatohet eshte 2x2 m duke pasur parasysh terrenin ne 1 ha 2500 fidane dhe per siperfaqen e marre ne studim nga ana jone nr. fidaneve eshte 10000. Ne caktimin e skemave e dendesise se mbjelljeve u mbeshetm jo vetem ne kerkesat e llojit dhe aftesise potenciale te stacionit si dhe ne pjerresine e terrenit.

Madhësia e gropës 40x40x40 cm. Skema e mbjelljes 2 x2 m.



Pishat e mbjella në tava plastike & dhe vegjetal do të përdoren për pyllëzim vetëm pasi të kenë kaluar një periudhë vegetacioni në tava plastike.

Për të gjitha llojet e pishave mesdhetare fidanat do të plotësojnë kushtet si në tabelën e mëposhtme:

Nr	EMERTIMI	MOSHA	DIMENSIONET		Ambalazhi
			Ø/mm	H/cm	
1	Pishë mesdhetare	1-2	4-10	20-25	Me tava plastike & dhe vegjetal



Figura Nr. 1 Fidanë të pishës mësdhetare në tava plastike.

6.10. Kujdesimet pas mbjelljes se pemeve

Shërbimet kulturale janë parashikuar që të realizohen për 3 vjet. Për vitin e parë është parashikuar që të bëhen 2 plehrime me plehra kimik me përmbajtje azoti dhe potasi, 2 prashitje, 2 uitje, mbulim me bar ose gjeth për hijezimin e fidanave gjatë periudhës së ngrohtë të verës si dhe zbulimi i tyre.

Prashitja e parë dhe e dytë do të shoqërohen me plehërim kimik. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 20-25gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Duhet patur kujdes që plehu të hidhet vetëm p sasinë e fidanave që mund të prashiten brenda ditës pasi në rast se ai mbetet i pa mbulluar i humbet elementët ushqyes të bimës

Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune duke u përshkuar me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 30cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkriçimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore.

Në periudhën e thatë të verës do të bëhen 2 uitje duke përdorur 30 litër ujë për fidan.

Mbulimi (hijezi) i fidanëve do të bëhet kur fillojnë temperaturat e larta, duke shfrytëzuar mjete rrethore si bar apo gjethe. Gjatë shërbimeve të vitit të dytë e tretë, nuk është parashikuar mbulimi i fidanave.

6.11. Masat dhe pagesa

Pagesa për përmbushjen nga ana e kontraktorit e këtij seksioni (mbjellja e pemëve) do të mbulohet nga pagesa e kontraktorit e parashikuar në preventiv. Pagesa do të bëhet mujore dhe do të mbahet pjesërisht ose plotësisht në rast mosperputhje me këto kritere dhe do të jetë e përkuperueshme deri në fund të periudhës së kontratës.



Preventivat e punimeve



Kontrata për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimeve të objektit Makaresh në ekonominë pyjore "Kraštë-Krujë"

Faqe Nr. 1 Pyllëzim me llojin Pishë mesdhetare

Objekti i fatures No.	Objekti i pageses No.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi (Lek)	Sasia (Lek)
	1.1	Kerkesa te pergjithshme Pregatitje piketash 2,500 pcs, 1000 cope per dite	Dite pune/ 1 ha	3	1,016	3,048
	1.2	Piketim gropash në fushë (2 punëtorë)n, 2,500 cope, 650 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	4	1,016	4,064
	1.3	Hapje gropash me përmasa 40 x 40 x 40 cm në tokë mesatare, 2,500 cope total 45 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	56	1,016	56,896
	1.4	Transport fidanash halorë 2 vjeçar (me tokë), në blloqe pyllëzimi 200 - 500 m largësi; 2,500 cope me 200 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	13	1,016	13,208
	1.5	Mbjellje fidanash të përgatitur në lava plastike në gropa me madhësi 40 x 40 x 40 cm, e llojit pisha e eger, 2,500 cope, 60 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	42	1,016	42,672
	1.6	Sigurimet shoqerore te pages minimale 1,016 L/dite				20,021
Non-shuma						139,909
		Shpenzime te pergjithshme (8%)				11,193
		Fitimi i planifikuar (10%)				13,991
	1.7	Blerje dhe transport fidanash	Cope/ 1 ha	2,500	78	195,000
	1.8	Gërmim e transport dheu, kat. I-rë me skrepër L=100m, V=6-6.5 m³	m³ ha	500	117	58,500
Non-shuma 1						418,593
		TVSH(20%)				83,719
Non-shuma 2						502,311
		Shpenzime totale per 30.6 ha		30.6	502,311	15,370,717
Total faqe 1 (perfshiro TVSH)						15,370,717

AlbGarden shpk



[Handwritten signature]

Kontrata për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimeve të objektit Makaresh në ekonominë pyjore "Krastë-Krujë

Faqe nr. 2 Zevendesim fidanesh

Objekti i fatures No.	Objekti i pageses No.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi (Lek)	Sasia (Lek)
	2.1	Kerkesa te pergjithshme Rihapje gropash në zëvendësime, 500 cope me 100 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	5	1,016	5,080 0
	2.2	Transport fidanash halorë 2 vjeçar (me tokë), në blloqe pyllëzimi 200 - 500 m largësi, 500 cope me 200 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	2.5	1,016	2,540 0
	2.3	Mbjellje fidanash të përgatitur në gropa me madhësi 40 x 40 x 40 cm, e llojit pishe mesdhetare; 500 cope me 60 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	8	1,016	8,128
		Shuma 1				15,748
		Sigurime shoqërore (16.7%)				2,630
		nenshuma				18,378
		Shpenzime te pergjithshme (8%)				1,470
		Fitim i planifikuar (10%)				1,838
		Shuma 2				21,686
	2.4	Blerje dhe transport fidanash	Cope/1 ha	500	78	39,000
		Shuma 3				60,686
		TVSH (20%)				12,137
		Sasia totale per ha				72,823
		Sasia totale per 30.6 ha		30.6		2,228,388
Totali i faqes nr. 2 (përfshirë TVSH)						2,228,388

AlbGarden shpk



Handwritten signature in blue ink.

Kontrata për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimeve të objektit Makarësh në ekonominë pyjore "Krashtë-Krujë"
Sipërfaqja 30.6 ha

Faqe nr. 3 Shërbime kulturore

Objekti i faktures No.	Objekti i pageses No.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi (Lek)	Sasia (Lek)
	3.1	Prashlirje (me shatë) fidanash në gropa më pak se 50 x 50 x 50 me rreze 0.3 m, (2 herë): 15,000 cope, me 300 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	51	1,016	51,816
	3.2	Hedhje plehu kimik rreth fidanit ne pyllëzime (2 herë) 15,000 cope, me 1,500 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	9	1,016	9,144
	3.3	Ujitje fidanash në pyllëzime me 30 l ujë, kur ujl është mbi 100 m largësi (2 herë):15,000 cope at 100 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	150	1,016	152,400
	3.4	Mbulim fidanash me bar. 7,500 cope me 500 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	5	1,016	5,080
	3.5	Zbulim fidanash nga bari: 7,500 cope me 1,200 cope/dite	Dite pune/ 1 ha	2	1,016	2,032
		Nen-shuma 1				220,472
		Sigurime shoqerore (16.7%)				36,819
		Nen-shuma 2				257,291
		Shpenzime te pergjithshme (8%)				20,583
		Filim i planifikuar (10%)				25,729
		Nen-Shuma 3				303,603
	3.4	Blerje plehu kimik	Kv	1	5,600	5,600
		Nen-shuma 3				309,203
		TVSH (20%)				61,041
		Sasia totale per ha				371,044
		Sasia totale per 30.6 ha		30.6	371,044	11,353,948
		Totali i faqes nr. 3 (perqshire TVSH)				11,353,946



Handwritten signature

Kontrata për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimeve të objektit Makaresh në ekonominë pyjore "Krastë-Krujë
Sipërfaqja 30.6 hektare

Permbledhese e preventivit

Faqe No.	Pershkrimi	Sasia (Lek)
1	Pyllëzim me llojin pishë mesdhetare	15,370,717
2	Zevendesim fidanesh	2,228,388
3	Sherbime kulturale	11,353,946
	Nen-shuma e faqeve	28,953,051
	Dite pune-sigurim objekti	506,949
	Nen-shuma	29,460,000
	Cmimi i Tenderit (përfshirë TVSH)	29,460,000



Handwritten mark or signature.

Projekti





**MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

PROJEKT

**Për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimeve të objektit
Makaresh në ekonominë pyjore “Krastë-Krujë”**

**Hartuar, në mbështetje të Urdhërit Nr. __, datë _____, të Ministrit
të Mjedisit, Z. Lefter KOKA.**

Tiranë, Qershor 2014

"Projekt për Rehabilitimin e Objektivit Makaresh në Ekonominë Pyjore Krastë-Krujë".





HYRJJE

Aktiviteti minerar privat, në rrethin e Krujës, Zonën e Makareshit, ekonominë pyjore Krastë-Krujë, ka filluar në vitin 2000 dhe deri në fund të vitit 2013, janë regjistruar gjithsej 54 leje minerare shfrytëzimi. Shumica e lejeve minerare të shfrytëzimit në rrethin e Krujës janë: 47 leje minerare për mineralin e Gurit Gëlqeror (ose 87 %), 5 leje minerare për mineralin e argjilës dhe nga 1 leje për mineralet: brekcie shpati dhe ranor silicor.

Lejet minerare në këtë rreth janë të shpërndara në Ekonominë pyjore Krastë-Krujë dhe kryesisht në objektin e studimit Makaresh. Minerali që del nga shfrytëzimet e karerave gurore në këtë zonë shërben si lëndë e parë për fabrikat e çimentos në Krujë, prodhim gëlqereje dhe ndërtim.

Nga kontrollat e ushtruara në vitin 2014, në këtë zonë u vu re se, në rrethin e Krujës disa prej këtyre lejeve ju ka mbaruar afati i lejës minerare, të tjera janë në proces shtyerje afati të lejes minerare.

Në këtë rreth prodhohet rreth 80 % e prodhimit të përgjithshëm të gurit gëlqeror, kjo i dedikohet dy fabrikave të çimentove që operojnë në këtë zonë, "Antea Cement" sh.a dhe "Fushë Krujë Cement Factory" sh.p.k, fabrika këto që prodhojnë rreth 2 000 000 ton cimento në vit. Këto fabrika si lëndë të parë përdorin mineralet e gurin gëlqeror, argjilës dhe gips-alabastrës dhe pozicionimi i tyre në këtë zonë i dedikohet cilësisë shumë të mirë të gurit gëlqeror, si dhe pozicioni gjeografik shumë të përshtatshëm, sepse ndodhet shumë afër kryeqytetit të vendit Tiranës dhe portit më të madh të vendit, ai i Durrësit.

Një problem i madh i konstatuar në rrethin e Krujës, dhe konkretisht në E.P. Krastë Krujë (zonë në të cilën operojnë këta subjekte) është edhe zhvillimi i aktivitetit minerar nga ana e subjekteve të palicencuara dhe i furrave të gëlqeres që ekzistojnë, të cilat jo vetëm zhvillojnë veprimtari të paligjshme, por sjellin edhe një dëm mjedisor si nga pikëpamja vizive, por edhe nga emetimet në atmosferë të gazrave të dëmshëm.

Masat e marra kohët e fundit nga Ministria e Mjedisit, në drejtim të mbylljes së furrave të gëlqeres në Krujë, apo lancimi i idesë për mos dhënie të lejeve të reja, mos miratimin e





shtyerjes së afatit 10-vjecar në këtë zonë, kanë sjellë dukshëm përmirësimin e situatës mjedisore në këtë zonë.

Mbeshtetur në këto arsytetime si dhe duke parë gjendjen e rënduar të tokës pyjore, në këtë objekt, u ndërmor studimi për rehabilitimin e saj nëpërmjet pyllëzimeve.

Një shqetësim i madh i vërejtur kohët e fundit, është mos-korrektësia e rehabilitimit të zonës nën përdorim të subjekteve private. Megjithëse në pajisjen e tyre me leje mjedisore dhe leje të shfrytëzimit minerar, ato paraqesin projekte të rehabilitimit, në asnjërin nga subjektet e kontrolluara në datën 31.03.2014, nuk ka filluar ky proces.

Pretendimet e subjekteve për mos-fillimin e punimeve të rehabilitimit, të zonës që kanë në përdorim, sipas tyre lidhen me sipërfaqen e vogël që ato kanë nën administrim. Shfrytëzimi i zonës kalon në disa faza, dhe ato nuk mund të fillojnë procesin e rehabilitimit, pasi një investim i tillë do të shkatërrohej nga shpërthimet që kryejne subjektet në zonë.

Gjithsesi nga evidentimi i sipërfaqes në këtë zonë gjatë kontrollit të ushtruar në datën 31.03.2014, në bashkëpunim dhe me ekspertët e AKBN dhe të Ministrisë së Energjitikës, u konkludua se aktualisht mund të fillohet rehabilitimi në 30% të sipërfaqes totale nën përdorimin.

Grupi i punës mbështetur në Urdhërin __, datë __/__/2014, të Ministrit të Mjedisit Z. Lefter Koka, nisi menjëherë punën për analizimin e gjendjes aktuale në ekonominë pyjore Krastë-Krujë dhe gjetjen e hartimin e masave të nevojshme për rehabilitimin e saj nëpërmjet pyllëzimeve. Pyllëzimi i objektit Makaresh, sjell jo vetëm përmirësimin e gjendjes së mjedisit në këtë zonë, por në të njëjtën kohë ai rregullon edhe aspektet vizive të zonës, e cila është e dukshme nga porta ajrore hyrëse e vendit tonë, Rinasit.

Projekti i cili është i detajuar në vijim, paraqet situatën aktuale të objektit Makaresh, dhe jep zgjidhje e alternativa për rehabilitimin e tij nëpërmjet pyllëzimeve me llojet e pishave mesdhetare. Zgjedhja e zonave për pyllëzim është studiuar në mënyrë të detajuar, me synim garantimin e suksesit të projektit.

"Projekt për Rehabilitimin e Objektit Makaresh në Ekonominë Pyjore Krastë-Krujë".





1. Qëllimi dhe objektivat

Ky projekt u mbështet në urdhërin Nr.____, datë __/__.2014, të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit.

Qëllimi i këtij projekti është të rehabilitojë zonën e Makareshit në ekonominë pyjore Krastë të Krujës, nëpërmjet pyllëzimeve.

Ky projekt është mbështetur për realizimin e qëllimit të tij, nëpërmjet plotësimit të objektivave të mëposhtme:

1. Analizë e hollësishme e gjendjes aktuale të objektit Makaresh nëpërmjet studimeve të drejtpërdrejta në terren.
2. Të hartojë masa rehabilitimi dhe preventivimin mbi kostot respektive.

Të rehabilitojë nëpërmjet pyllëzimit, sipërfaqet e degraduara si pasojë e shfrytëzimit të terrenit nga subjekte për prodhim guri gëlqeror dhe inerte.

DETYRA E PROJEKTIT

Mbjellje e llojit Pishë meshdhetare (egër), në vendet e abandonuara nga subjekte të paidentifikuar dhe në sheshet e karrave të cilat u ka mbaruar afati i lejes së shfrytëzimit.

INVESTITOR: Buxheti i Shtetit nëpërmjet FZHR, dhe donacione të ndryshme.

BURIMI I FINANCIMIT: Fondi Shqipëtar i Zhvillimit

OBJEKTI I PUNIMEVE: Zona Makaresh, në ekonominë pyjore "Krastë-Krujë".
Pyllëzim pjesor, në ngastrat 77d, 78b, 78c, 78c, 79d, 82, 83a, 84a, 85a.

FILLIMI I PUNIMEVE: Dhjetor 2014

AFATI I PERFUNDIMIT TE PUNIMEVE: Dhjetor 2016

NGASTRAT KU DO TE KRYHEN PUNIMET: 77d, 78b, 78c, 78c, 79d, 82, 83a, 84a, 85a.





LLOJI I PUNIMEVE: Pyllëzim me fidanë pishë mesdhetare (egër), dhe sistemim sheshesh për t'i përshtatur për mbjellje.

NGARKOHET PER PROJEKTIN DHE KONTROLLIN: Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës, Seksioni i Pyjeve në Krujë në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve në Ministrinë e Mjedisit.

KAPITULLI I PARË

1. VENDOSJA GJEOGRAFIKE

Zona e Makareshit, është pjesa qendrore e Ekonomisë Pyjore "Krastë-Krujë". Vetë ekonomia pyjore shtrihet në pllajën gëlqerore me kundrejtim perëndimor, poshtë qytetit të Krujës. Ka shtrirje gjatësore Veri – Jug. Skaji jugor i ekonomisë fillon në Fushë-Krujë dhe përfundon në skajin Verior të sajë, afër Mamurrasit.

Ekonomia pyjore Kraste e Krujes bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të Fushë Krujës dhe Borizanës. Kjo ekonomi shtrihet nga Lumi i Drojes deri në lumin e Zezes duke përfshirë Kodrat e Borizanes, Krastes dhe malin e Krujes. Kundrejtimi i përgjithshëm i ekonomisë pyjore është ai perëndimor.

Objekti: "Makaresh", bën pjesë në ekonominë pyjore "Kraste-Krujë", me koordinatë gjeografike dhe konkretisht: gjatësia gjeografike $41^{\circ}25'40''$, gjeresia gjeografike $19^{\circ}45'44''$, të identifikuar me sistemin Nomenklatura **K-34-88-B-c (Kruja)**.

2. KUFLIT NATYRORE

Në veri fillon mbi qytetin e Mamurrasit, për të vazhduar në drejtimin Veri-Jug, deri në qytetin e Fushë Krujës. Zona e Makareshit ku do të kryhen punimet e pyllëzimit, është thuajse qendra e ekonomisë. Karakterizohet nga një reliev në formë pllaje, me proska të vogla në drejtim zbritës Lindje-Perëndim. Në lidhje me ekonomitë e tjera objekti kufizohet me:





Ne veri me ekonomine pyjore Shemni Brrat
Ne lindje me ekonomine pyjore Qafe-Shtame
Ne jug me ekonomine pyjore Bura-Mali i Gamnit
Ne perendim me toka bujqesore

3. VELLIMI I PUNIMEVE QE DO TE KRYHEN

Nga përlogaritjet paraprake, në punime do të përfshihet një sipërfaqe prej 30.6 Ha. Kjo sipërfaqe nuk do të jetë e gjitha e vazhdueshme, pasi disa subjekte vazhdojnë të shfrytëzojnë akoma në rrugë të ligjshme mbi bazë lejesh për ushtrim aktiviteti.

Do të ketë të planifikuara në këtë projekt edhe disa punime të tjera të karakterit mbajtës kundër rrëshqitjes. Këta punime do të planifikohen më vehte, pasi janë vepra të karakterit inxhinierik.

Punimet përfshijnë të gjitha operacionet e punës që nevojiten për pyllëzimin e një objekti, ku përfshihen:

Piketimi i sipërfaqes ku do të kryhen pyllëzimet

Hapja e gropave në përmasat 40 x 40 x 40 cm (përmasimi jepet në gjatësi, gjërësi dhe thellësi të gropës).

Procesi i mbjelljes së fidanëve, dhe shërbimet kulturore të objektit i cili zgjat 3 (tre vjet), për të garantuar suksesin e zënshmërisë.

Në total nga preventivimi i operacioneve të punës nevojitet një shumë prej rreth 30 milione leke.

4. VARTESIA ADMINISTRATIVE

Zona e Makareshit, është pjesë e ekonomisë Pyjore Krastë - Krujë dhe administrohet nga Seksioni i Pyjeve të rrethit të Krujës, Drejtoria e Shërbimit Pyjor të Durrësit.





5. HISTORIKU I PUNIMEVE TE KRYERA

Gjatë viteve 1974-1980, e gjithë zona në fjalë u përfshi nga një projekt pyllëzimi, i cili pati sukses në krijimin e peisazhit dekorativ të të gjithë pllajës. Para këtyre viteve, pllaja ka qenë e veshur me bimësi të tipit shkurre dhe me njolla.

Pas kryerjes së pyllëzimeve me pishë të egër, të cilat e ritheksojmë se qenë shumë të suksesshme për kohën, masivi pati një zhvillim konstant.

Gjatë viteve 1991 deri në ditët e sotme, masivi është shfrytëzuar për prodhimin e gurit gëlqeror dhe për material inerte, ku në zonën në fjalë, është shkatërruar e gjitha mbulesa vegjetative.

KAPITULLI I DYTË

KUSHTEVE STACIONALE

1. GJEOMORFOLOGJIA

Zona e Makarëshit dhe e gjithë ekonomia pyjore Krastë – Krujë, karakterizohen nga masivë gëlqerorë. Njolla të vogla prej argjile dhe shtresash dheu janë tashmë evidente në sipërfaqe si pasojë e aktiviteteve të alternimit dhe erozionit shekullor. Këta njolla krijojnë kushte të favorshme për implantimin e bimësisë. Objekti Makarësh në teresi formohet nga terrene të vazuara me shpate dhe kodra, trafshina të vogla të lidhura me sheshina të karjeres dhe furrave të gëlqeres. Pjerrësia natyrale e terrenit varion nga 7°-18°, ndërsa në vendet ku është ndërhyrë me punime të shfrytëzimit për prodhimin e gurit gëlqeror, janë krijuar sheshe me pjerrësi të vogël, ku pyllëzimi edhe në sajë të mbeturinave (dhera dhe argjila) është në kushte të favorshme.

2. LARTESIA MBI NIVELIN E DETIT

Konfiguracioni i objektit ku do të kryhen pyllëzimet, ashtu si edhe më sipër theksuam është një pllajë natyrale me kundrejtim perëndimor, e karakterizuar nga fragmentime





natyrale në formë të valëzuar, të cilat krijohen nga rrjeti hidrik dhe karakteristikat e gëlqerorëve gjatë procesit të alterimit. Objekti Makaresh bën pjesë në zonën kodrinore dhe për pasojë karakterizohet nga lartësi jo shuë të theksuara.

Lartësia maksimale e objektit në fjalë është 400m dhe ajo minimale 150 m. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 275 m.

3. HIDROLOGJIA

Konfiguracioni i pllajës në të cilin është vendosur objekti i planifikuar për ndërhyrje me punime të pyllëzimit, është i valëzuar për shkak të rrjetit hidrik. Rrjeti hidrik nuk është aktiv për një periudhë të gjatë të vitit, për shkak të përbërjes gjeologjike të masivit. Masivet gëlqerorë kryesisht karakterizohen nga rrjete hidrike të thata për më shumë se 8-9 muaj të vitit. Si i tillë edhe rrjeti hidrik i objektit ku do të kryhen pyllëzimet është i thatë. Nuk ka burime natyrale apo rrjedha ujore, në të gjithë sipërfaqen e marrë në studim. Vetëm gjatë muajve të dimrit njëra nga prroskat në objekt ka rrjedhje ujore, por edhe kjo me pjesë.

4. KLIMA

Ekonomia pyjore Krasta e Krujës bën pjesë në zonën me klime mesdhetare kodrinore. Kjo zone karakterizohet nga një dimer i butë dhe i lagët dhe nga një vere e thatë dhe me pak reshje. Temperatura mesatare vjetore është 13.6⁰C. Vlerat minimale të temperaturës arrihen në muajin Janar -2⁰C, kurse vlerat maksimale në muajin Korrik në 37⁰C. Duke u nisur nga kushtet klimatike të kësaj zone themi se këto kushte janë të përshtatshme për rritjen e Pishes mesdhetare. Për zhvillimin e këtij lloji pyjor, rrezik përbejnë ngricat e pranveres. Reshjet janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin normal të druveve pyjore. Sasia vjetore e reshjeve që bien në zone shkon në 1690 mm/vit.

Objekti Makaresh përfshihet në zonën klimatike mesdhetare fushore, në zonën qendrore. Temperatura mesatare vjetore varion nga 14.8-15⁰. Temperaturat minimale janë regjistruar nga 6.3-6.5⁰ dhe i janë regjistruar gjatë fundit të muajit dhjetor. Temperatura maksimale janë ato të muajit gusht 33-33.4⁰. Sasia e reshjeve mesatare që bien në zone është e bollshme dhe arrin vlerën 1390.6 mm në vit. Regjimi i reshjeve maksimale është





ne periudhen e dimrit dhe arrihet në muajt Nëntor-Janar. Ne disa vite eshte nje periudhe kritike nga muaji Qershor-Shtator. Edhe ditet me reshje qe jane te shfrytezueshme nga kulturat (mbi 20 mm) ne pergjithesi jane te mjaftueshme per nje zhvillim normal te kulturave qe propozohen per tu mbjelle si per pishen e eger dhe ullirin e selvine të cilat janë edhe kultura autoktone të zonës.

a. Temperatura

Objekti Makaresh perfshihet ne zonen klimatike mesdhetare fushore, nenzona qendrore. Temperatura mesatare vjetore varion nga 14.8-15⁰. Temperaturat minimale jane rregjistruar nga 6.3-6.5⁰ dhe i janë regjistruar gjatë fundit te muajit dhjetor. Temperatura maximale jane ato te muajt gusht 33-33.4⁰. Sasia e reshjeve mesatare qe bien ne zone eshte e bollshme dhe arrin vleren 1390.6 mm ne vit. Regjimi i reshjeve maximale eshte ne periudhen e dimrit dhe arrihet në muajt Nëntor-Janar. Ne disa vite eshte nje periudhe kritike nga muaji Qershor-Shtator. Edhe ditet me reshje qe jane te shfrytezueshme nga kulturat (mbi 20 mm) ne pergjithesi jane te mjaftueshme per nje zhvillim normal te kulturave qe propozohen per tu mbjelle si per pishen e eger dhe ullirin e selvine të cilat janë edhe kultura autoktone të zonës.

b. Reshjet

Sasia e reshjeve mesatare qe bien ne zone eshte e bollshme dhe arrin vleren 1390.6 mm ne vit. Regjimi i reshjeve maximale eshte ne periudhen e dimrit dhe arrihet në muajt Nëntor-Janar. Ne disa vite eshte nje periudhe kritike nga muaji Qershor-Shtator. Edhe ditet me reshje qe jane te shfrytezueshme nga kulturat (mbi 20 mm) ne pergjithesi jane te mjaftueshme per nje zhvillim normal te kulturave qe propozohen per tu mbjelle si per pishen e eger dhe ullirin e selvine të cilat janë edhe kultura autoktone të zonës.

c. Ererat

Pllaja në të cilën shtrihet objekti jonë i studimit goditet nga ererat e forta jugperëndimore, kryesisht në rastet e stuhive. Ndërsa zakonisht drejtimi i crërave është ai Veri – Jug, gjatë





verës. Erërat me përjashtim të stuhive nuk janë faktor pengues për pyllëzimin që parashikohet të kryhet në këtë objekt.

4. GJEOLLOGJIA.

Pilaja në të cilën është vendosur objekti i marrë në studim karakterizohet nga masive gëlqerorë. Alterimi i vazhdueshëm i gëlqerorëve, ka krijuar xhepa me përmbajtje aluvionesh dhe dekompozime natyrale të cilat favorizojnë bimësinë eksituose, por edhe atë që implantohet artificialisht. Zona e Makareshit, për vetë kompozimin gjeologjik me përmbajtje gëlqerore, i është nënshtruar një presioni të jashtëzakonshëm shfrytëzimi gjatë viteve 1991-2014. Bimësia natyrale dhe ajo e vendosur gjatë pyllëzimeve artificiale të masivit të Krastës (1970-1980), në zonën e dhënë për prodhim gurë gëlqeror është zhdukur totalisht nga gërmimet dhe hapja e karerave. Rehabilitimi i cili është detyrim ligjor i subjekteve të cilët ushtrojnë aktivitetet prodhues e shfrytëzimi në këtë zonë nuk është kryer.

5. TOKA

Objekti i marre ne studim eshte i vendosur mbi toka te hinjta kafe te kuqremta me nje profil terthor te padifemcuar mire ne horizonte. Njgyra e ketyre tokave eshte e hinjte kafe, jane toka me sasi te paket humusi ne siperfaqe (1.5-2.5%). Keto toka kane nje reaksion nga acid deri ne neutral. Jane toka te varfra me fosfor, mesatarisht te pasura me azot. Horizonti siperfaqesor eshte i ceket dhe i ngjeshur. Keto toka jane te vendosura mbi shkembinj amnor gëlqerore. Objekti Makaresh ne pergjithesi karakterizohet nga formacionet shkembore seadimentare (gëlqeror). Toka ka forme skeletike dhe është nën presionin e vazhdueshëm të proceseve të alterimit, karakterizohet nga structure kokrrizore. Tipet e tokave në objektin e pyllëzimit (Makaresh) jane, toka kafe te hinjta (HK), me nëntip toka të kuqremta.

Per sa i perket reaksionit te tokes (pH) jane mesatarisht acide dhe shkojne deri neutral. Theksojme gjithashtu se reaksioni i tokes ne disa vende ndryshon mbasi ne vendin ku ka skorje nga djegiet e furrave te gelqeres me goma, mbeturina plastike e solar vërehet një ndotje e cila pengon implantimin natyral dhe artificial të bimësisë. Këta vende do t'u nënshtrohen proceseve të rehabilitimit nëpërmjet grumbullimit të mbeturinave dhe kavaletimit e mbulimit të tyre më një shtresë dheu prej 20 cm.





KAPITULLI I TRETE

PERSHKIMI I BIMESISE EGZISTUESE

Në zonën e Makareshit, dhe kryesisht zona që i është nënshtruar ndërhyrjeve me shfrytëzime minerale sipërfaqësore, bimësia eksistuese është vetëm një nocion, pasi e gjithë sipërfaqja aktualisht është e zhveshur. Në vendet afër zonës së pa-prekur të pyllit artificial të pishës mesdhetare, ka filluar instalimi natyral i pishës, por theksojmë se është shumë e rrallë dhe vazhdimisht dëmtohet nga shpërthimet në zonë.

Më parë ndërhyrjes me pyllëzime artificiale (1970-1980) bimësia eksistuese karakterizohet nga ajo e zonës së dafinës (lauretum). Në zonën e poshtme është ndërhyrë edhe me kultivimin e plantacioneve të ullirit, i cili edhe ai gjendet aktualisht i dëmtuar.

a. Zonat fitoklimatike:

Objekti Makaresh i marrë në studim ben pjesë në zone fitoklimatike të zonës së dafinës (Lauretum) e cila është karakteristikë e lartësive nga 0- 457m mbi nivelin e detit. Pisha mesdhetare është një specie e cila përshtrahet me këtë zone. Llojet e bimesise drunore qe jane instaluar per rreth ketij objekti jane Pisha e eger, Krifsha etj.

Bimesia barishtore perberse e vendosur per rreth ketij objekti eshte kryesisht e llojit graminace dhe pjesen tjeter e perbejne leguminozet me nje perqindje bimesh medicionale si zhubrica e sherbela.

b. Llojet perberese

Llojet përbërëse të zonës para ndërhyrjes me punime të shfrytëzimit minirar për nxjerrje guri gëlqeror, kanë qenë llojet e pishave mesdhetare, me dominancë të llojit pishë e egër dhe më pak edhe pidhe e butë dhe pishë e detit, e përzier edhe me lloje autoktonë si krifsha, lloje të ndryshme të dushqeve (ilqe), fillorea, etj.





c. Gjendja e parcelave ku do të kryhen punimet.

Ashtu si dhe më sipër theksuam gjendja e parcelave në të cilat do të kryhen pyllëzime pjesore është totalisht e shkatërruar nga bimësia. E gjithë sipërfaqja nën shfrytëzim është e zhveshur. Problem shqetësues janë togjet e inerteve dhe dherave të mbetura në zona të veçanta të këtyre parcelave, tashmë të abandonuara nga subjekte që u ka mbaruar leja e shfrytëzimit apo ilegale të cilat janë larguar nga objekti.

Procesit të rehabilitimit dhe pyllëzimit pjesor do t'i nënshtrohen vetëm pjesët e abandonuara nga subjektet. Togjet e dherave dhe të mbeturinave inerte do të sheshohen e më pas do të përshtaten për mbjelljen e fidanëve të pishës mesdhetare.

Nr. Ng.	Emertimi ngastres	Sipërfaqja reale e ngastres (Ha)	Pershkrimi i ngastres	Sip. për t'u pyllëzuar (Ha)	Skema e formula e pyllëzimit
82	Stanet e Nojes ne Kraste	44	Shpat, lartesi 250-400 m Kundrejtim Perendimor pjeresia 7°.	2.5	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
83/a	Gurorja Makedonë	17	Shpat, lartesi 200-250 m Kundrejtim Perendimor. pjeresia 10°.	9.5	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
84/a	Mbi guroren makedonë	48.5	Lugine, lartesi 250-400 m Kundrejtim Perendimor pjeresia 18°.	4.3	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
85/a	Faqja mbi Makedonë	36.25	Shpat, lartesi 150-350 m Kundrejtim J-P pjeresia 13°.	3	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
77/a	Faqja e Zidollit	22.75	Shpat, lartesi 200-350 m Kundrejtim Verior pjeresia 19°.	0.4	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
79/d	Pisha mbi Guroren e vjeter	32.50	Shpat, lartesi 200-350 m Kundrejtim Verior pjeresia 16°.	0.5	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
78/b	Mbi repartin Zidoll	7.5	Shpat, lartesi 250-300 m Kundrejtim Jugor pjeresia 18°.	4.8	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm





78/c	Shullani i prroit Zidollit	36.5	Shpat. lartësi 250-350 m Kundrejtim Jugor pjerësia 14°	5.6	10 PM, 2 x2 m me gropa 40x40x40 cm
Totali				30.6	

Përcaktime:

10 PM – lloji që do të përdoret do të jetë i gjithi pishë mesdhetare;

2 x 2 m - gjatësia dhe gjërësia e krijimit të rreshtave midis fidanëve në skemën e pyllëzimit;

40 x 40 x 40 cm - përmasat e hapjes së gropave para mbjelljes, të cilat përkojnë me gjatësinë, gjërësinë dhe thellësinë e saj.

KAPITULLI I KATERT

MASAT QE DO TE MERREN

Pyllëzimi pjesor i këtyre ngastrave, presupozon ndërhyrjen me punime rehabilitimi e pyllëzimi në sipërfaqet që aktualisht nuk punohet nga subjektet akoma aktive në zonë. Prgatitja e terrenit për mbjellje do të kërkojë edhe sheshimin e disa togjeve të mbeturinave inerte e dherave të cilat do të jenë të preventivuara më poshtë.

E gjithë zona e pyllëzuar do të vihet nën masa strikte mbrojtje, dhe për një periudhë 3 vjeçare (2014-2017), i gjithë objekti do t'u nënshtrohet punimeve të kujdesimit (prashitje e fidaëve, ujitje, dhe zëvendësim). Të gjitha operacionet e punimeve që do të kryhen, do të jenë preventivuar e llogaritur më poshtë.

1. QELLIMI I NDERHYRJES

Rehabilitimi e rikthimi i peisazhit natyror, nëpërmjet pyllëzimit me pishë mesdhetare do të jetë synimi kryesor i këtij investimi. Zona në fjalë ka pamje ballore me aeroportin "Nënë Tereza", dhe krijon një imazh të shëmtuar për vizitorët e turistët që vizitojnë vendin tonë.





2. PUNIMET QE PROPOZOHEN

Punimet që do të kryhen gjatë operacionit të mbjelljeve do të jenë, sheshimi i vendeve me togje dhe e mbeturinash inerte, piketimi i sipërfaqes për hapjen e gropave, procesi i hapjes së gropave dhe më pas mbjellja e fidanëve. Pas mbjelljes do të preventivohen e llogariten edhe shërbimet e kujdesimit për tre vite me radhë, me synimin për të garantuar zënshmërinë, dhe suksesin e pyllëzimit.

Piketimi bëhet nga dy punëtorë, nën drejtimin e specialistit. Gjatë përcaktimit të distancës ndërmjet rrjeshtave, në funksion të pjerrësisë së terrenit, të bëhet reduktimi i distancës sipas tabelave të posaçme ose me metoda të thjeshta të cilat mund të realizohen nga specialist me përvojë.

Pas piketimit, fillon hapja e gropave. Gropat do kenë dimensione 40 x 40 x 40 cm. Piketa e vendosur përcakton mesin e gropes. Gjatë hapjes së gropes, shtresa e sipërme e dheut duhet të ndahet nga shtresa e poshtme. Në mënyrë që lagështira e tokës të ruhet sa më gjatë, fundi i gropes duhet të ketë pak pendencë nga pjerrësia e shpatit. Gjatë punimit bëhet shkëputimi i dheut si dhe pastrimi nga gurët e mbeturinave të tjera.

Nr	N/gastra	Formula e pyllëzimit	Skema mbjelljes	Sipërfaqia (ne Ha)	Nevoja për fidana halor (copë)
1	82	10 PM	2 x 2 m	2.5	6 250
2	83/a	10 PM	2 x 2 m	9.5	23 750
3	84/a	10 PM	2 x 2 m	4.3	10 750
4	85/a	10 PM	2 x 2 m	3	7 500
5	77/a	10 PM	2 x 2 m	0.4	1 000
6	79/d	10 PM	2 x 2 m	0.5	1 250
7	78/b	10 PM	2 x 2 m	4.8	12 000
8	78/c	10 PM	2 x 2 m	5.6	14 000
	SHUMA			30.6	76 500

Do t'i nënshtohm punimeve të pyllëzimit një sipërfaqe prej 30.6 Ha, me një nevojë për fidanë të pishës mesdhetare prej 76 500 copë.





3. ZGJEDHJA E LLOJEVE DHE FORMULAVE TE PYLLEZIMIT

Zgjedhja e llojeve është mbështetur në historikun e ndërhyrjeve artificial të kryer në zonën e studimit, si dhe në zonën fitoklimatike. Duke qenë se zona e Makareshit ka qene e gjitha e pyllëzuar nga pishë mesdhetare dhe objekti i pyllëzuar ka qenë i suksesshëm, lloji i përzgjedhur do të jetë pisha mesdhetare, me formulë pyllëzimi 10 Pishë Mesdhetare.

4. SKEMA E MBJELLJES

Duke marrë parasysh konfiguracionin e terrenit si dhe nevojën e llojit të zgjedhur për ushqim e dritëzim, skema e mbjelljes e aplikuar do të jetë 2 x 2 m. Kjo skemë garanton zhvillim normal të pishës mesdhetare dhe përshtatet me konfiguracionin e terrenit.

5. MATERIALI MBJELLES

Faktor kryesor dhe mjaft i rëndësishëm në realizimin e përqindjes sa më të lartë të zënjeve dhe zhvillimit normal të grumbullit pyjor është cilësia e fidanëve dhe farës që do përdoren për mbjellje.

Fidanat të jenë 2 vjeçar, me qeska dhe brenda parametrave cilësor të përcaktuara në standartet në fuqi, të pa prekur nga sëmundje e dëmtues.

Fidanat duhet të merren nga një fidanishte pranë objektit të planifikuar për pyllëzim. Nëse kjo nuk është e mundur, ata duhet të trajtohen në një shpërngultore në afërsi të objektit së paku për një periudhë 6 mujore, duke u garantuar të gjitha shërbimet e nevojshme, në mënyrë që të aklimatizohen dhe të përshtaten me mjedisin natyror ku do mbillen.

Farat duhet të jenë elitare, të marra nga grumbujt farore për të cilët janë kryer studime nga ana e IKPK apo FSHP, për mundësi të perhapjes. Ato duhet të jenë brenda parametrave cilësorë të përcaktuara në standarte si dhe të dezinfektuara me preparate kimike që i mbrojnë nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Fuqia mbirëse e farave duhet të jetë mbi 85 %.





Fidanat dhe farat duhet të jenë të shoqëruar me dokument origjine dhe të çertifikuara nga strukturat përkatëse.

Bazuar në skemat, formulat e pyllëzimit dhe sipërfaqen e planifikuar për pyllëzim nevojat për material mbjellës janë.

Nr.	Emërtimi	Njësia matjes	Gjithsej	Nga kjo:	
				Pyllëzime	Zëvendësime
1	Fidane të llojit Pishë mesdhetare	Copë	76 500	76 500	15 300

6. KOHA E MBJELLJES DHE TEKNIKAT E ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Mbjellja e fidanave të bëhet në periudhën e pushimit të vegjetacionit, në ditë pa ngrica, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi rrënjor nga ngricat.

Transporti i fidanave brenda parcelës do bëhet me krah. Gjatë transportit dhe shpërndarjes së fidanave në objekt duhet të tregohet kujdes në mënyrë që ata të mos dëmtohen mekanikisht. Shpërndarja e fidanave sipas llojeve do bëhet në funksion të formulës së parashikuar për ç' do parcelë.

Mbjellja do të bëhet nga dy punëtor të specializuar dhe instruktuar paraprakisht nga specialistët përkatës për mënyrën e kryerjes së këtijë procesi. Në fillim do të hidhet në gropë dheu i pjesës së sipërme të ndarë gjatë hapjes së gropës. Para mbjelljes do të hiqet me kujdes qeska e plasmasit në mënyrë që të mos krijohet shpëputje të sistemi rrënjor të fidanit nga shtresa e dheut. Kur në fund të qeskes ka rrënjë të përdredhur, ato shkurtohen me kujdes me gërrshërë të posaqme.

Fidani me bukë dheu, vendoset në qendër të gropës, në mënyrë që të ruhet skema e mbjelljes. Qafa e rrënjës së fidanit të jetë 2 – 3 cm nën nivelin e pjesës së sipërme të gropës. Gropa mbushet me dhe anash fidanit duke e ngjeshur here pas here me kujdes, në mënyrë që të sigurohet kontakti i dheut të fidanit me atë të hedhur në gropë. Gjatë mbushjes së gropës me dhe dhe ngjeshjes, të tregohet kujdes në mënyrë që fidani të ruhet i padëmtuar. Pas mbjelljes së fidanit, dheu do të ngjeshet me kujdes, në mënyrë që të eliminohen fluskat e ajrit të tokës të cilat influencjnë negative në drejtim të zenjes së tijë. Në zona të thata sipërfaqes së gropës i jepet formë konkave, ndërsa në ato pjesë ku toka mund të mbajë lageshti, forma konvekse. Gurët që rezultojnë gjatë mbushjes së gropës,





vendosen në pjesën e poshtme të sajë në formë muri, në mënyrë që të mbrojnë terrenin nga erozioni.

Afatet e kryerjes së punimeve, lloji dhe cilësia e fidanëve dhe farës si dhe teknika e zbatimit të punimeve gjatë mbjelljes, gjatë procesit të zëvendësimeve, i cili do të kryhet vitin e dytë pas mbjelljes, do jenë siç u përshkruan më lart.

Shërbimet kulturale janë parashikuar që të realizohen për 3 vjet. Për vitin e parë është parashikuar që të bëhen 2 plehrime me plehra kimik me përmbajtje azoti dhe potasi, 2 prashitje, 2 uitje, mbulim me bar ose gjethe për hijezimin e fidanave gjatë periudhës së ngrohtë të verës si dhe zbulimi i tyre.

Prashitja e parë dhe e dytë do të shoqërohen me plehërim kimik. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 20-25 gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune duke u përshkruar me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 30cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkriftimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore.

Në periudhën e thatë të verës do të bëhen 2 uitje duke përdorur 30 litër ujë për fidan.

Mbulimi (hijezimi) i fidanëve do të bëhet kur fillojnë temperaturat e larta, duke shfrytëzuar mjete rrethore si bar apo gjethe. Gjatë shërbimeve të vitit të dytë e tretë, nuk është parashikuar mbulimi i fidanave.

7. GRAFIKU I REALIZIMIT TE PUNIMEVE

Nr	Ngastra N/Ngastra	Siperfaqja qe do te mbillet (në ha)	Viti i mbjelljes
1	82	2.5	2014
2	83/a	9.5	2014
3	84/a	4.3	2014
4	85/a	3	2014
5	77/a	0.4	2014
6	79/d	0.5	2014
7	78/b	4.8	2014
8	78/c	5.6	2014
TOTALI		30.6	

Projekt për Rehabilitimin e Objektivit Makarësh në Ekonominë Pyjore Krastë-Krujë.





Ashtu sikurse vërehet edhe nga tabela më sipër i gjithë objekti do të pyllëzohet brenda vitit 2014. Shërbimet e kujdesimit do të vijojnë edhe gjatë për tre vite të tjera 2015, 2016 dhe 2017.



Gjetë procesit të preventivimit të punimeve, normat për ç'do operacion pune janë marrë nga libri "*Normat e punës me krah dhe me kafshë për punimet bujqësore dhe pyjore*", botuar nga Ministria e Bujqësisë në vitin 1986, ndërsa paga ditore është planifikuar në mbështetje të Vendimit Nr. 573, date 03.07.2013 "*Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi*".

Në funksion të të parashikimit të përqindjes së zënjeve, është parashikuar dhe zëri zëvendësime i cili është llogaritur për 15% të sipërfaqes totale.

I. TEKNIKA E ZBATIMIT TE PUNIMEVE TE PYLLEZIMIT

Skica e mbjelljes

Skema e pyllëzimit






Formula e pyllëzimit është 10 pishë mesdhetare.

Skema e pyllëzimit që do të zbatohet është 2x2 m duke pasur parasysh terrenin në 1 ha 2500 fidane dhe për sipërfaqen e marrë në studim nga ana jone nr. fidaneve është 10 000. Në caktimin e skemave e dendësise së mbjelljeve u mbështetm jo vetëm në kërkesat e llojit dhe aftësisë potenciale të stacionit si dhe në pjerresinë e terrenit.

Madhësia e gropës 40x40x40 cm. Skema e mbjelljes 2 x 2 m.



Pishat e mbjella në tava plastike & dhe vegjetal do të përdoren për pyllëzim vetëm pasi të kenë kaluar një periudhë vegjetacioni në tava plastike.

Për të gjitha llojet e pishave mesdhetare fidanat do të plotësojnë kushtet si në tabelën e mëposhtme:



Nr	EMERTIMI	MOSHA	DIMENSIONET		Ambllazhi
			Ø/mm	H/cm	
1	Pishë mesdhotare	1-2	4-10	20-25	Me tava plastike & dhe vegetal



Figura Nr. 1 Fidanë të pishës mesdhotare në tava plastike.

9. KUJDESI PAS MBJELLJES SE OBJEKTIT

Shërbimet kulturale janë parashikuar që të realizohen për 3 vjet. Për vitin e parë është parashikuar që të bëhen 2 plehrime me plehra kimik me përmbajtje azoti dhe potasi, 2 prashitje, 2 uitje, mbulim me bar ose gjeth për hijezimin e fidanave gjatë periudhës së ngrohtë të verës si dhe zbulimi i tyre.

Prashitja e parë dhe e dytë do të shoqërohen me plehërim kimik. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 20–25gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Duhet patur kujdes që plehu të hidhet vetëm p sasinë e fidanave që mund të prashiten brënda ditës pasi në rast se ai mbetet i pa mbulluar i humbet elementët ushqyes të bimës





Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune duke u përshtuar me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 30cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkruftimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore.

Në periudhën e thatë të verës do të bëhen 2 uitje duke përdorur 30 litër ujë për fidan.

Mbulimi (hijezimi) i fidanëve do të bëhet kur fillojnë temperaturat e larta, duke shfrytëzuar mjete rrethore si bar apo gjethe. Gjatë shërbimeve të vitit të dytë e tretë, nuk është parashikuar mbulimi i fidanave.

Ideuar dhe projektuar nga:

Drejtoria e Pyjeve
Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Grupi i punës:

Dr. Ing. Kliti STARJA

Ing. Rexhep PEKA

Dr. Ing. Behar HATË

Msc. Ing. Elmaz ISLAMI

Tiranë, Qershor 2014.



Sigurimi i Kontratës

[Handwritten signature]



FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS
Guaranty Certificate Performance Bond

Ref / Ref Numer	Data/ Date
Për/ To	(Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor / Name and address of Contracting Authority)
Në emër të In the name of	(Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar / Name and the address of the insured bidder)
Procedura e prokurimit (Procurement procedure)	(Referenca e dosjes përcaktuar sipas autoritetit kontraktor/ File reference according to contracting authority)
Pershkrim i shkurtër i kontrates (Short description of the contract)	(Lloji i procedurës dhe objekti / Kind of procedure and the object)
Publikimi (nese zbatohet) Publication (if applicable)	Buletini i njoftimeve të njoftimeve publike Dt. _____ Nr. _____
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur dhe me kusht që /referring to the former procedure, and with the condition that to:	
(emri i ofertuesit të përcaktuar fitues/ name of the bid winner)	
T'i jete akorduar kontrata, ne vertetojme se Has been accorded the contract, we certify that	(emri i ofertuesit të përcaktuar fitues/ name of the bid winner)
Eshte garantuar pranë shoqërisë së sigurimeve interalbani sh.a me një vlerë prej: Has a guaranty at our company that has a value:	(monedha dhe vlera e shprehur në fjale dhe në shifra/ value and currency)
Si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës që do të nënshkruhet me/as a condition for the execution of the contract signed with:	(emri i autoritetit kontraktor/ name of the contracting authority)
Marrim përsipar të transferojmë në llogarinë We are liable to transfer at the account of	(emri i autoritetit kontraktor / name of the contracting authority)
Vlerën e siguruar , brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e pare me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e kushteve të kontratës / the insured value within 15 (fifteen) days from your first written request, without giving any explanation, with the condition that this request mentions that the contract conditions are not met.	
Ky sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës/ this insurance is valid up to the contract execution:	
Nga data/ from	Deri më / Up to

[Handwritten signature]

interalbani sh.a
 VIENNA INSURANCE GROUP
[Handwritten signature]